

VENDIM
Nr. 18, datë 7.7.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Altin Binaj,	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Fiona Papajorgji,	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 28.6.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 1 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), përfaqësuar me autorizim nga Marash Logu.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Erind Mërkuri.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Embro Ahmetaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore’”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi pjesërisht i zbatimit të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore’”.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 84, 116, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave në datën 16.12.2019 ka nxjerrë aktin normativ nr. 9, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore” (*akti normativ nr. 9/2019*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 17.12.2019 dhe ka për objekt rregullimin e funksionimit të organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse (neni 1). Qëllimi i tij është përballimi i pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha

institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile (neni 2). Mes të tjerash, akti normativ nr. 9/2019 ka përcaktuar rregullat e posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese në funksion të procesit të rindërtimit, si dhe parimet e prokurimit publik për rindërtimin.

2. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës, me ligjin nr. 97/2019, datë 18.12.2019 (*ligji nr. 97/2019*) Kuvendi ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019 të Këshillit të Ministrave. Ligji është shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11398, datë 27.12.2019 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 182, datë 30.12.2019.

3. Në zbatim të aktit normativ nr. 9/2019 janë miratuar një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave që kanë pasur për objekt çështje të ndryshme. Kështu, me VKM-në nr. 199, datë 4.3.2020, “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit”, të ndryshuar me VKM-të nr. 688, datë 3.9.2020 dhe nr. 225, datë 12.4.2021, janë miratuar dokumentet standarde të procedurës së prokurimit për punë, shërbime dhe mallra, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, si dhe kushtet e marrëveshjes kuadër e të kontratës për rindërtimin. Referuar seksionit 4 të këtyre dokumenteve standarde, rezulton se lloji i procedurës është tender i kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit).

4. Në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit, që i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike (*kërkuesi*), i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar se ligji nr. 97/2019 bie në kundërshtim me nenet 11, 17 dhe 18 të Kushtetutës, për rrjedhojë ka kërkuar shfuqizimin pjesërisht të tij, si edhe pezullimin pjesërisht të zbatimit të këtij akti deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

5. Me vendimin e datës 11.3.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 18.3.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

6. Në lidhje me kërkesën për pezullimin pjesërisht të aktit normativ objekt kërkesë, me vendimin e datës 18.3.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur shqyrtimin e saj në seancë plenare.

7. Në seancën plenare të datës 28.6.2022, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, përfaqësuesi i kërkuesit kërkoi thirrjen në këtë gjykim si subjekt të interesuar të shoqatës Instituti Shqiptar i Shkencave, pasi ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen, jo vetëm referuar misionit të saj, por edhe në kushtet kur kjo shoqatë, e njohur për aktivitetin publik në funksion të transparencës për mënyrën e përdorimit të fondeve publike, monitoron në mënyrë të vazhdueshme procedurat e prokurimit publik, veçanërisht ato që lidhen me procesin e rindërtimit. Sipas kërkuesit, thirrja e kësaj shoqate si subjekt i interesuar do të ndihmojë gjykimin kushtetues me të dhëna faktike për sa u përket prokurimeve publike të realizuara në kuadër të procesit të rindërtimit.

8. Në lidhje me këtë kërkim përfaqësuesi i Kuvendit u shpreh se kërkesa duhet të rrëzohet, pasi Instituti Shqiptar i Shkencave nuk tërheq interes nga gjykimi kushtetues. Kërkuesi ka kërkuar të paraqesë në gjykim studimet që mund të ketë bërë ky subjekt si të dhëna shkencore në mbështetje të argumenteve të tij, por në këtë rast duhej të kishte kërkuar thirrjen e tij në cilësinë e dëshmitarit ose të ekspertit, bazuar në ligjin organik të Gjykatës. Këto të dhëna, që sipas vetë kërkuesit janë publike, ai nuk kishte asnjë pengesë që t’i paraqiste në gjykimin kushtetues ose që të paraqiste kërkesë në Gjykatë për këtë veprim procedural që kërkon të kryhet. Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kërkoi rrëzimin e kërkesës, pasi Instituti Shqiptar i Shkencave nuk ka interes për t’u thirrur në këtë proces. Në rast se do të kishte ndonjë interes për këtë shoqatë ajo mund të thirrej në një pozitë tjetër procedurale, por jo në atë të personit të tretë. Po kështu, nëse ka raporte që do të duhet të prezantohen në seancë, Këshilli i Ministrave ka nevojë të marrë kohë dhe të bëjë edhe një ballafaqim të fakteve të pretenduara nga shoqata. Megjithatë, kjo nuk çmohet e arsyeshme në funksion të ekonomisë gjyqësore dhe nuk do të sjellë ndonjë të re për procesin.

9. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë paraprake, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar. Në nenin 39 të ligjit nr. 8577/2000 janë përcaktuar subjektet që marrin pjesë në gjykimin kushtetues, kurse lidhur me subjektet e interesuara që thirren në çështje me interes publik, Gjykata është shprehur se është në diskrecionin e saj përcaktimi i këtyre subjekteve. Në këtë drejtim ajo niset nga

interesi që ka thirrja e tyre për të kontribuar në vendimmarrjen për çështjen që shqyrtohet. Vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por dhe të gjyqimit kushtetues dhe në këtë kuptim në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë apo rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuarit apo dhe kryesisht nga Gjykata (*shtih vendimet nr. 9, datë 1.3.2021; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, në lidhje me kërkesën për thirrjen si subjekt të interesuar të shoqatës Instituti Shqiptar i Shkencave, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk arriti të provojë ekzistencën e interesit të drejtpërdrejtë të këtij subjekti në lidhje me çështjen në shqyrtim. Për më tepër, në kushtet kur, sipas kërkuarit, të dhënat statistikore që kërkohen të paraqiten nga ky subjekt bazohen në të dhëna të aksesueshme publikisht, ajo vlerësoi se nuk ekziston nevoja e pjesëmarrjes së këtij subjekti as për nevoja të këtij gjykimi kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuari ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

10.1 *Për kërkesën për pezullimin pjesërisht të zbatimit të aktit normativ*

10.1.1 Zbatimi i aktit normativ nr. 9/2019, i miratuar me ligjin nr. 97/2019, sjell pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve. Pasoja konsiston në humbjen e vlerave monetare nga buxheti i shtetit për procesin e rindërtimit, për shkak se mallrat dhe shërbimet për këtë proces nuk u nënshtrohen procedurave normale të prokurimit publik, që do të siguronin një konkurrencë të ndershme dhe efektivitet të kostos në kryerjen e tyre. Prandaj, zbatimi i ligjit nr. 97/2019 duhet pezulluar deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

10.2 *Për themelin e kërkesës*

10.2.1 Akti normativ i kundërshtuar cenon *lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës, në raport me nenet 17 dhe 18 të saj, pasi nuk respekton parimet themelore në fushën e prokurimeve publike, siç janë ato të drejtësisë, barazisë, transparencës, konkurrencës dhe efektivitetit të kostos. Ligji për prokurimin publik është një ligj organik që normon të gjitha prokurimet publike për mallra, shërbime ose punë publike. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*ligji nr. 9643/2006*) (në fuqi në periudhën e miratimit të aktit normativ nr. 9/2019) dhe ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” (*ligji nr. 162/2020*) kanë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shteruese edhe procedura prokurimi në raste emergjente, siç mund të jetë ajo e fatkeqësisë natyrore. Një procedurë e parashikuar nga ligjvënisi për këto raste është ajo me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës.

10.2.2 Përcaktimi i një procedure të përshpejtuar në aktin normativ nr. 9/2019 e më tej në VKM-në nr. 199/2020 ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e operatorëve ekonomikë dhe pjesëmarrjen në procedurë. Afatet e shkurtra për pranimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë e ka kufizuar në mënyrë drastike konkurrencën, pasi është pothuajse e pamundur të përgatisësh një set të madh dokumentesh për një periudhë 10-ditore. Edhe afati 2-ditor për ankimin ndaj kriterëve të procedurës së prokurimit, të cilat krijojnë premisa ose pamundësojnë pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, është kufizues, kurse afati 3-ditor i trajtimit të kërkesës është tërësisht joobjektiv. Duke qenë se procedurat sipas aktit normativ janë mbi kufirin e lartë monetar dhe kanë volum dokumentacioni, afati 10-ditor i vlerësimit të ofertave e vë në vështirësi serioze cilësinë e vlerësimit dhe mundësinë e verifikimit objektiv të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit. Përcaktimi i këtyre afateve të ngushta cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimet e vetë aktit normativ nr. 9/2019, që është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si dhe integritetin, besimin publik dhe transparencën. Edhe vlera e sigurimit të kontratës në masën 15%, pra më e lartë se sa ajo e parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik, sjell diskriminim të operatorëve ekonomikë në procedura të përshpejtuara në raport me ata që konkurrojnë me procedura normale.

10.2.3 Në kushtet kur vendi *de jure* dhe *de facto* nuk është më në gjendje të jashtëzakonshme, është e pashpjegueshme që të qëndrojnë në fuqi akti i kundërshtuar, që përmban dispozita dhe procedura të

veçanta prokurimi. Për më tepër, ligji nr. 162/2020 në fuqi rregullon në mënyrë tërësore fushën e prokurimeve publike, në përputhje me direktivat e legjislacionit të BE-së, duke i dhënë zgjidhje çdo situatë, qoftë emergjente, qoftë normale, në të cilën gjendet autoriteti kontraktues.

11. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar si vijon:

11.1 Për kërkesën për pezullim

11.1.1 Në analizë të kriterëve të parashikuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577/2000, nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar thellësisht nevojën për marrjen e një mase të tillë ekstreme, për më tepër kur aktet prezumohen si kushtetuese. Në këtë situatë, si edhe kur akti normativ me fuqinë e ligjit ka mbi 2 vjet që zbatohet dhe shumë kontrata prokurimi janë lidhur tashmë, pezullimi i tij jo vetëm që nuk do të kishte efekt, por do të cenonte interesin publik.

11.2 Për legjitimitimin e kërkesës:

11.2.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur tej afatit të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Bazuar në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës, akti normativ me fuqinë e ligjit hyn në fuqi menjëherë dhe në këtë rast nuk gjejmë zbatim nenet 84 dhe 117 të Kushtetutës. Akti normativ nr. 9/2019 ka hyrë në fuqi në datën 16.12.2019 dhe afati për kundërshtimin e tij përfundonte më 16.12.2021.

11.3 Për themelin e kërkesës:

11.3.1 Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i pabazuar. Pas goditjes së vendit nga tërmeti i datës 26.11.2019, pasojat e të cilit ishin të rënda në jetë njerëzish dhe dëme materiale, u konstatua se kuadri ligjor në fuqi nuk ishte i mjaftueshëm, ndaj u miratua akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019. Duke iu referuar kufizimeve të nenit 17 të Kushtetutës, kriteri i kufizimit me ligj plotësohet, pasi është bërë me akt normativ me fuqinë e ligjit të miratuar nga Kuvendi. Po kështu, qartazi jemi para një interesi publik, pasi, sipas pikave 1 dhe 2 të aktit normativ nr. 9/2019, qëllimi i tij është përballimi i pasojave që vijnë si rezultat i fatkeqësive natyrore. Akti normativ nr. 9/2019 respekton edhe kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes për këto arsye: *Së pari*, si rezultat i fatkeqësisë natyrore pati shumë persona të pastrehë ose sepse banesat u shembën ose sepse u bënë të pabanueshme. *Së dyti*, akti normativ zbatohet në mënyrë të kufizuar, pasi duhet që Këshilli i Ministrave, sipas nenit 174 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të shpallë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë territorin e vendit ose pjesë të tij. Në këto kushte, shmangia e ligjit nr. 162/2020 ndodh në raste shumë të kufizuara. *Së treti*, procedura e prokurimit në këto raste rregullohet nga nenet 40–44 të aktit normativ. Edhe pse në dukje afatet janë të shkurtra, ato janë normale në një procedurë prokurimi urgjente, që ka si qëllim mënjanimin e pasojave të ardhura nga një fatkeqësi natyrore.

11.3.2 Pretendimi se procedura e përcaktuar nga akti normativ nuk ndihmon në zhvillimin e konkurrencës është i pabazuar, pasi në këtë rast prioritar mbetet mënjanimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore. Konstatimet e kërkuarit nuk qëndrojnë, pasi nuk mund të bëhet krahasimi mes parashikimeve të aktit normativ nr. 9/2019 me ato të ligjeve nr. 9643/2006 dhe nr. 162/2020. Në rastin e parë jemi para një prokurimi në kushte emergjente, kurse në të dytin para një procedure të hapur që zhvillohet në kushte normale. I pabazuar është edhe pretendimi se shoqëritë tregtare në fushën e ndërtimit nuk kanë afat të mjaftueshëm të dorëzojnë dokumentacionin teknik, pasi kjo fazë ka qëllim vetëm identifikimin e subjekteve që veprojnë në këtë fushë dhe mundësive që ato kanë. Në lidhje me shoqëritë e huaja, ato që veprojnë në Shqipëri kanë hapur degë dhe kanë bërë ekuivalentimin e licencave sipas VKM-së përkatëse. Nga informacioni i dhënë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit janë 13 subjekte të huaja që kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit në këtë rast.

11.3.3 Në lidhje me pretendimin se afatet janë shumë të shkurtra, ato janë në funksion të afateve të përgjithshme të parashikuara nga akti normativ dhe synojnë shpejtësinë dhe efektivitetin në këtë procedurë. Pretendimi se afati 10-ditor për shqyrtimin e ofertave vë në dyshim seriozitetin e vlerësimit është abuziv, pasi duke u ndodhur para një fatkeqësie natyrore njësitë zbatuese janë të dedikuara maksimalisht për shmangien e pasojave. Edhe pretendimi për vlerën e sigurimit të kontratës në masën 15% është haptazi i pabazuar. Procedura e prokurimit është sa e veçantë aq edhe serioze, pasi flitet për krijimin sa më të shpejtë të kushteve për strehim për personat e pastrehë për shkak të fatkeqësisë natyrore.

11.3.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë, nga përmbajtja e kërkesës ai nuk rezulton të jetë trajtuar në mënyrë shteruese, pra nuk del e qartë se përse cenohet nga akti normativ nr. 9/2019, ndërsa argumentet kanë të bëjnë me raportin midis aktit normativ nr. 9/2019 dhe ligjeve për prokurimin publik.

12. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar si vijon:

12.1 Për kërkesën për pezullim

12.1.1 Në lidhje me kërkimin për pezullimin e zbatimit të aktit nuk ka asnjë analizë për lidhjen e drejtpërdrejtë mes shkëlqes së lirisë ekonomike e parimit të barazisë dhe dëmit që mund t'u vijë operatorëve ekonomikë ose buxhetit të shtetit. Për më tepër, ligji ka më shumë se 1 vit që ka filluar prodhimin e pasojave dhe në institucionet që e zbatojnë atë nuk është paraqitur asnjë kërkesë që ka të bëjë me kushtet dhe termat për zhvillimin e procedurave konkurruese. Kërkuesi nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale për rrezikun e pasojave të mundshme nga zbatimi i aktit objekt kërkesë, sipas kërkesave të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000.

12.2 Për legjitimitimin e kërkesës

12.2.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Akti normativ me fuqinë e ligjit, i cili hyn në fuqi menjëherë, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 17.12.2019, kurse kërkesa është paraqitur më 30.12.2021, pra tej afatit ligjor 2-vjeçar. Përveç botimit ky akt është njoftuar publikisht menjëherë pas nxjerrjes së tij dhe për të janë respektuar kërkesat që rrjedhin nga neni 101 i Kushtetutës.

12.2.2 Kërkuesi nuk legjitimohet as *ratione materiae*, pasi pretendimet nuk janë ngritur në nivel kushtetues, por kanë të bëjnë me raportin që duhet të kenë në zbatim dy norma me fuqi të njëjtë juridike. Kërkuesi prezumon antikushtetutshmërinë e aktit normativ vlerësuar sipas standardeve të një ligji tjetër, me të njëjtën fuqi juridike, ndërkohë që konfliktet në lidhje me mënyrën e interpretimit të ligjit ose të ligjshmërisë nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

12.3 Për themelin e pretendimeve

12.3.1 Kërkuesi antikushtetutshmërinë e pretenduar e lidh kryesisht me procedurën e përshpejtuar të prokurimit (nenet 40 dhe 42) dhe vlerën e sigurimit të kontratës (neni 43). Përkundër sa pretendon kërkuesi, akti normativ nr. 9/2019 ka të gjitha garancitë për të zhvilluar procedura konkurruese të hapura, duke u dhënë mundësi të gjitha subjekteve për t'u përfshirë. Neni 41 i këtij akti parashikon parimet mbi të cilat bazohet prokurimi publik, që janë të njëjta me ato të ligjit për prokurimin publik dhe pasqyrojnë edhe parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative (KPA).

12.3.2 Zhvillimi i një gare publike mund të prekë aspekte të lirisë dhe veprimtarisë ekonomike, sipas nenit 11 të Kushtetutës, por nuk ka rezervë kushtetuese për kushtet në të cilat duhet zhvilluar kjo. Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kushtet e fatkeqësisë natyrore është kërkesë e ligjit për prokurimin publik nr. 9643/2006, i cili në nenin 5, pika 2, shkronja "c", parashikon se dispozitat e tij nuk gjejnë zbatim për raste të veçanta, të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, konflikte të armatosura, operacione luftarake, stërvitje ushtarake dhe pjesëmarrje në misione ushtarake jashtë vendit. Miratimi i aktit normativ ka qenë i deleguar nga vetë ligji për prokurimin publik në fuqi dhe ai përmban të gjitha parimet e prokurimit publik për zhvillimin e një gare të ndershme, madje ka një rregullim të ngjashëm të procedurave konkurruese.

12.3.3 Të pabazuara janë edhe pretendimet për paligjshmërinë e neneve 42 dhe 43 të aktit normativ nr. 9/2019, të cilat nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë, por me paligjshmërinë. Bazuar në detyrimin e parashikuar në nenin 59 të Kushtetutës, duke qenë në kushtet e emergjencës dhe nevojës së ngutshme për strehim, është i detyrueshëm zbatimi i masave të përshpejtuara administrative për të bërë të mundur akomodimin e mbi 3000 familjeve. Afatet procedurale nuk janë detyrime kushtetuese, madje as KPA-ja nuk parashikon afate standarde për kryerjen e procedurave të caktuara. Ato i janë lënë në dorë ligjvënësit për t'i rregulluar në varësi të procedurave dhe kushteve në të cilat zhvillohen.

12.3.4 Sipas të dhënave të Agjencisë së Prokurimit Publik, që nga viti 2020, kur ka filluar të zbatohet akti normativ nr. 9/2019, janë zhvilluar 300 procedura dhe në to ka pasur në total 2588 oferta, pra afatet dhe kushtet e aplikuar nuk i kanë penguar subjektet për të marrë pjesë. Në lidhje me pretendimin e diskriminimit dhe kufizimit të së drejtës së ankimit, referuar të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik, gjatë viteve 2019–2022 janë trajtuar gjithsej 11 kërkesa për

procedurat e prokurimit me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (faza e vlerësimit të ofertave). Shifrat tregojnë se afatet procedurale nuk kanë penguar shqyrtimin në kohë të tyre dhe as garën.

12.3.5 I pabazuar është edhe pretendimi se shoqëritë e huaja cenohen nga këto afate procedurale, pasi duhet të sjellin një dokumentacion voluminoz, i cili duhet të përkthehet dhe apostilohet. Sipas legjislacionit të brendshëm, shoqëritë e huaja për pjesëmarrjen në gara publike duhet jo thjesht të paraqesin informacionin e kërkuar, por edhe të bëjnë njohje dhe ekuivalentim të licencave. Nga të gjitha subjektet që operojnë në Shqipëri, 13 prej tyre kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit për qëllime të rindërtimit. Nuk është e qartë se cilat standarde statistikore përdor kërkuesi për vlerësimin ose jo të konkurrencës, pasi nga të dhënat statistikore janë më shumë se 50% e shoqërive të huaja në Shqipëri që operojnë në fushën e studim-projektimit dhe më shumë se 30% e shoqërive që operojnë në fushën e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve që kanë marrë pjesë në procedurat për efekt të rindërtimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuarit

A.1. Për legjitimimin racione personae

13. Çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në lidhje me legjitimimin e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve për iniciimin e kontrollit abstrakt të normës ligjore, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normës mund të zbatohet ndaj akteve ligjore pavarësisht nga efekti që ato mund kenë në një konflikt aktual ose të pritshëm dhe, në një rast të tillë, nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar këtë subjekt para Gjykatës, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi, një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar, i cili nuk ka nevojë të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë në lidhje me çështjen në shqyrtim për shkak të interesit publik që mbart, dhe, si i tillë, legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së aktit normativ të kundërshtuar.

A.2. Për legjitimimin racione temporis

16. Kërkuesi ka parashtruar se objekt i kërkesës së tij është ligji nr. 97/2019, i cili ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019, teksti i të cilit, pas miratimit, inkorporohet te ligji miratues, ndaj objekt i kontrollit kushtetues janë dispozita të caktuara të këtij ligji. Duke qenë se në rast të mosmiratimit të aktit normativ nga Kuvendi ai humbet fuqinë që nga fillimi, e drejta për t’iu drejtuar Gjykatës lind nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit miratues. Kurse për sa i përket momentit nga fillon të llogaritet afati 2-vjeçar, në kushtet kur në ligjin objekt kërkesë nuk ka asnjë përcaktim për sa i përket hyrjes së tij në fuqi, do të merret në konsideratë afati kushtetues i parashikuar nga neni 84, pika 3, i Kushtetutës, që është 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

17. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, kërkuesi nuk legjitimohet *racione temporis*, pasi bazuar në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës akti normativ me

fuqinë e ligjit hyn në fuqi menjëherë dhe në këtë rast nuk gjejnë zbatim nenet 84 dhe 117 të Kushtetutës. Jo vetëm që ligjit nr. 97/2019 i mungon neni klasik i hyrjes në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, por edhe jurisprudenca kushtetuese ligjin miratues e konsideron me fuqi prapavepruese. Edhe nëse do të pranohej se kërkuksi legjitimohet vetëm për ligjin, ky i fundit mban datën 18.12.2019, ndërsa kërkesa është paraqitur më 30.12.2021, pra jashtë afatit 2-vjeçar.

18. Gjykata vëren se bazuar në përmbajtjen e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën është 2 vjet nga hyrja në fuqi e aktit. Akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019, datë 16.12.2019 ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 17.12.2019. Në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës, ky akt normativ me fuqinë e ligjit është miratuar brenda 45 ditëve me ligjin nr. 97/2019 të Kuvendit, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 182, datë 30.12.2019. Në tekstin e ligjit nuk ka ndonjë dispozitë që të shprehet për kohën e hyrjes së tij në fuqi.

19. Sipas pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa mund të paraqitet dorazi ose me postë dhe në rastin e dërgimit të kërkesës me postë, datë e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare. Gjithashtu, sipas pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 8577/2000, kur kërkesa paraqitet e plotësuar brenda afatit, si datë e paraqitjes së saj konsiderohet data e paraqitjes për herë të parë në Gjykatë. Kërkesa në shqyrtim, edhe pse mban datën 30.12.2021, është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar në datën 14.1.2022 (sipas shënimit përkatës të këtij shërbimi). Ajo është regjistruar në Gjykatë në datën 17.1.2022, fillimisht si e paplotë dhe pas plotësimit të saj nga kërkuksi është regjistruar përfundimisht në regjistrin e posaçëm të kërkesave në datën 31.1.2022. Për rrjedhojë, data e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë, për efekt të llogaritjes së afatit ligjor 2-vjeçar, është data 14.1.2022.

20. Në lidhje me aktin objekt të këtij gjykimi kushtetues, kërkuksi në objekt të kërkesës ka kundërshtuar ligjin nr. 97/2019, i cili ka këtë përmbajtje: *“Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*. Kurse referuar thelbit të pretendimeve të kërkesës, sikurse u saktësua edhe në seancë plenare, ato kanë të bëjnë me përmbajtjen e disa dispozitave të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019, më konkretisht me dispozitat e kreut VI të aktit normativ (nenet 40–44) që përcaktojnë rregullat e posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese në funksion të procesit të rindërtimit, ndërkohë që kërkuksi nuk ka ngritur pretendime në lidhje me aspektet formale ose procedurën e miratimit të ligjit nr. 97/2019.

21. Gjykata, bazuar në rregullimin e nenit 101 të Kushtetutës, është shprehur se akti normativ me fuqinë e ligjit është ligj në kuptimin material të termit, por jo në kuptimin formal të tij. Në thelb, ai rregullon marrëdhënie shoqërore të rëndësishme që meritojnë trajtim me ligj nga Kuvendi, por kur vërtetohet prania e nevojës dhe urgjencës, Kushtetuta lejon që iniciativën ligjvënëse, në këtë rast, ta kryejë Këshilli i Ministrave. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se fuqia juridike e aktit normativ me fuqinë e ligjit është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij, sepse kjo vlerë e normës përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike që gjen rregullim në të dhe jo nga organi që e ka miratuar (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 23, datë 16.4.2014; nr. 24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kuvendi ruan të drejtën e vlerësimit përfundimtar të këtij akti dhe, nëse e miraton atë, e kthen në ligj edhe në kuptimin formal. Akti normativ me fuqinë e ligjit vepron për një periudhë kohe maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e kësaj norme lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi. Nëse akti nuk miratohet nga Kuvendi ose nuk merret në shqyrtim prej tij, me kalimin e periudhës 45-ditore, ai jo vetëm nuk prodhon më efekte për të ardhmen, por, njëkohësisht, humbet fuqinë që nga fillimi (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 23, datë 16.4.2014; nr. 24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë rast Kuvendi nuk vepron në ushtrim të kompetencës legjislativë, e cila është ushtruar nga pushteti ekzekutiv, por në ushtrim të kontrollit parlamentar ndaj mënyrës se si është ushtruar kjo iniciative nga Këshilli i Ministrave. Kompetenca e Kuvendit në këtë rast konsiston në vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe në shprehjen e mendimit përfundimtar lidhur me aktin normativ. Natyra e këtij vlerësimi është politike, por dhe juridike. Kuvendi shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë

e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi. Ai është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Gjatë miratimit të aktit normativ Kuvendi ka diskrecion të zgjedhë një nga tri alternativat e mëposhtme: i. të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave; ii. ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë; iii. të heshtë derisa të plotësohet afati 45-ditor që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për t'u shprehur lidhur me aktin (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Alternativa e zgjedhur nga Kuvendi lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me perspektivën e mëtejshme të aktit normativ, pra nëse ai do të dalë nga rendi juridik apo do të bëhet pjesë e tij.

23. Në lidhje me kufijtë e juridiksionit kushtetues, ai nuk është vënë në diskutim gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, as në rastin kur Kuvendi ka shprehur vullnetin e tij me ligj miratues, por ky i fundit nuk është bërë objekt kundërshtimi, as kur objekt kundërshtimi ka qenë njëkohësisht si akti normativ, ashtu edhe ligji miratues (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se është detyrë dhe pjesë e natyrshme e juridiksionit të saj vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit normativ, ashtu dhe ligjit miratues të Kuvendit. Kontrolli mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të aktit normativ me fuqinë e ligjit shtrihet edhe mbi ligjin miratues, në referim të nenit 131, shkronja "a", të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Parë në këtë këndvështrim, por pa vënë në dyshim juridiksionin e saj për shqyrtimin e këtyre akteve normative, pra si të aktit normativ me fuqinë e ligjit, ashtu edhe të ligjit miratues të tij, Gjykata vuri në diskutim legjitimitimin *ratione temporis* të kërkesit në lidhje me momentin nga i cili fillon të llogaritet afati 2-vjeçar i paraqitjes së kërkesës, i parashikuar nga neni 50, pika 1, i po këtij ligji, pra nëse ai llogaritet nga koha e hyrjes në fuqi të aktit normativ me fuqinë e ligjit apo të ligjit miratues të tij dhe se kur hyn në fuqi ligji miratues i aktit normativ.

25. Sipas *njërit qëndrim* të gjyqtarëve, objekt i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i ligjit nr. 97/2019, me të cilin Kuvendi, pasi ka zhvilluar procesin vendimmarrës për vlerësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 101 të Kushtetutës në lidhje me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2019, ashtu edhe të përmbajtjes së tij, e ka shndërruar atë në ligj. Për këtë arsye në gjykimin kushtetues është thirrur si subjekt i interesuar edhe Kuvendi, si organi që ka nxjerrë aktin e kundërshtuar. Vetë *ratio* e dispozitës kushtetuese që parashikon se aktet normative me fuqinë e ligjit miratohen me ligj të Kuvendit është që ky i fundit të shprehë vullnetin në cilësinë e organit të cilit i përket pushteti legjislativ, duke u dhënë atyre fuqi juridike të mëtejshme. Kthimi i këtij akti në ligj edhe në aspektin formal sjell një rinovim të përmbajtjes së tij, duke përbërë ligji miratues një burim të ri të së drejtës, si dhe një stabilizim të efekteve të aktit normativ qeveritar, ndërsa mosmiratimi sjell humbjen e fuqisë së tij që nga fillimi.

26. Gjatë procesit të vlerësimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit Kuvendi ka të drejtën të ushtrojë edhe kompetencën e tij legjislativë, duke sjellë edhe ndryshime në përmbajtjen e aktit normativ, pra duke shtuar, ndryshuar ose edhe shfuqizuar dispozita të tij. Megjithatë, pavarësisht nëse Kuvendi e ushtron ose jo pushtetin e tij legjislativ në këtë drejtim, kjo nuk sjell asnjë ndryshim në lidhje me momentin e hyrjes në fuqi të ligjit miratues dhe, në këtë kuptim, as në lidhje me momentin nga fillon llogaritja e afatit për kundërshtimin e tij. Për rrjedhojë, kërkesi mund të kundërshtojë menjëherë në Gjykatën Kushtetuese aktin normativ me fuqinë e ligjit që nga momenti i hyrjes së tij në fuqi, me rrezikun që kjo kërkesë mund të ngelet pa objekt në eventualitetin e mosmiratimit të tij nga Kuvendi, ose të rezervojë të drejtën të kundërshtojë aktin normativ me fuqinë e ligjit së bashku me ligjin miratues, i cili e bën të përhershëm dhe përfundimtar rregullimin e përcaktuar në mënyrë të përkohshme me aktin normativ me fuqinë e ligjit. Miratimi i ligjit, pavarësisht nëse e ndryshon ose e riprodhon përmbajtjen e akti normativ, ka efekt të përsërisë, duke rinovuar burimin, cenimin nga i cili buron interesi për të vepruar (i përgjithshëm për subjektet e pakushtëzuara ose individual për subjektet e kushtëzuara). Në një rast të tillë, afati fillon të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit miratues, pavarësisht nëse ai ka sjellë ose jo ndryshime në aktin normativ. Po të njëjtin qëndrim ka mbajtur në jurisprudencë konstante dhe të konsoliduar edhe Gjykata Kushtetuese Italiane (*shih, ndër të tjera, vendimet nr. 72/2014; nr. 139/2012; nr. 430/2007; nr. 272/2004, të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

27. Nga ana tjetër, procesi ligjvënës është i sanksionuar në nenet 81–85 të Kushtetutës. Konkretisht, në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit, neni 84, pika 3, i Kushtetutës vendos rregullin e përgjithshëm të kalimit të jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare, me përjashtimin e përcaktuar në pikën 4 të tij, sipas të cilit në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Në kushtet kur ligji nr. 97/2019 nuk përmban si bazë ligjore pikën 4 të nenit 84 të Kushtetutës dhe as parashikimin e hyrjes në fuqi menjëherë të tij, konsiderohet se zbatohet rregulli i përgjithshëm i hyrjes në fuqi pas 15 ditësh nga botimi në Fletoren Zyrtare, çka nënkupton se kërkesa është e paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar¹.

28. Ndërsa sipas *qëndrimit tjetër* të gjyqtarëve, baza kushtetuese në këtë rast është neni 101 i Kushtetutës. Kjo dispozitë ka parashikuar aktin normativ me fuqinë e ligjit si akt i natyrës kushtetuese, në tërësi, si për sa u përket kritereve të nxjerrjes së tij, qëllimit që kërkon të arrijë, procedurës që duhet ndjekur në mënyrë që mos ta humbasë fuqinë që nga fillimi, afateve të miratimit nga Kuvendi, efekteve të tij, ashtu edhe humbjes së këtyre efekteve. Bazuar në këtë dispozitë, akti normativ me fuqinë e ligjit hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare, me të vetmin kusht që, nëse nuk miratohet nga Kuvendi brenda 45 ditëve, efektet e tij humbasin fuqinë që nga fillimi. Akti normativ me fuqinë e ligjit i nënshtrohet kontrollit të Kuvendit, i cili bën një vlerësim të ekzistencës së kushteve të nevojës dhe urgjencës për të legjitimuar ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga ana e Këshillit të Ministrave, por po ashtu edhe të përmbajtjes së tij. Në këtë drejtim, Kuvendi nuk ka asnjë pengesë kushtetuese që të ndërhyjë në përmbajtjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, në ushtrim të pushtetit të tij legjislativ, duke ndryshuar, shtuar ose shfuqizuar dispozita të tij.

29. Në rastin në shqyrtim, Kuvendi ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit pa sjellë asnjë ndryshim në përmbajtjen e tij. Ligji miratues nr. 97/2019 ka miratuar efektet tashmë të prodhuara të aktit normativ me fuqinë e ligjit që nga fillimi, duke lejuar që ai të vijojë të prodhojë efekte edhe për të ardhmen. Edhe sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, të cituar edhe më sipër, është theksuar se: “... *fuqia e aktit normativ me fuqinë e ligjit është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij, sepse kjo vlerë e normës përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike që gjeneron rregullim në të dhe jo nga organi që e ka miratuar. Fuqia juridike është element i pandashëm i përmbajtjes së normës*” (shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 23, datë 16.4.2014; nr. 24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, për qëllime të llogaritjes së afatit 2-vjeçar do të konsiderohet data e hyrjes në fuqi e aktit normativ nr. 9/2019, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor.

30. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se është detyrë dhe pjesë e natyrshme e juridiksionit të saj vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit normativ, ashtu dhe ligjit miratues të Kuvendit. Kontrolli mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të aktit normativ me fuqinë e ligjit shtrihet edhe mbi ligjin miratues, në referim të nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës (shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Përveçse kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, edhe pretendimet e kërkuarit në rastin konkret, në thelb, lidhen me dispozitat e aktit normativ dhe ai nuk ka pretenduar shkelje lidhur me aspekte formale ose të meta procedurale të ligjit miratues. Në këtë kuptim, edhe në kuadër të parimit të sigurisë juridike, kërkuari kishte detyrimin të respektonte afatin ligjor *ratione temporis* për të iniciuar këtë gjykim kushtetues, me qëllimin për të adresuar pretendimet e tij për përmbajtjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit².

31. Në përfundim, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis* të kërkuarit, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, duke qenë se nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e një të pestës së deputetëve konsiderohet e rrëzuar.

¹ Votuan për legjitimitetin e kërkuarit me këtë arsye gjyqtarët Vitore Tusha, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Fiona Papajorgji.

² Votuan kundër legjitimitetit të kërkuarit me këtë arsye gjyqtarët Elsa Toska, Altin Binaj dhe Sandër Beci.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “c”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.7.2022.

Shpallur më 26.7.2022.

Kryetar: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sandër Beci